

In memoriam
Prof. dr. Emine Arifi-Bakalli
(1951-2024)



Prof. dr. Emine Arifi-Bakalli është një emër i shquar në historiografinë shqiptare, e cila me studimet e saja dhe kontribut të rëndësishëm në ndriçimin e shumë ngjarjeve të historisë sonë kombëtare gjatë shekullit XX. Emine Arifi-Bakalli u lind më 10 tetor të vitit 1951, në fshatin Babush i Muhaxherëve të Komunës së Ferizajt. Familja Arifi, ishte vendosur në fshatin Babush i Muhaxherëve, për shkak se kohë më parë ishin shpërngulur nga sanxhaku i Nishit, si pasojë e dhunës dhe përndjekjes nga ushtritë serbe.

Shkollimin fillor më 1966 dhe atë të mesëm më 1970, i kreu në Prishtinë. Pas përfundimit të shkollimit të mesëm, e etur për dituri dhe dije, nisi studimet për histori pranë Katedrës së Historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, të cilat i kreu në vitin 1974. Po pranë Katedrës së Historisë së Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, i përfundoi studime për magjistraturë, ku më 5 korrik të vitit 1977 mbrojti me suksese gradën magjistër e shkencave. Po në këtë universitet, më 5 prill të vitit 1984 mbrojti me suksese disertacionin e doktoratës po nga fusha e historisë.

Nga 15 nëntori i vitit 1974 e deri në vitin 2016 ka punuar pranë Katedrës së Historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku fillimisht kishte thirrjen e asistentes për të arritur deri te thirrja e fundit akademike, profesor i rregullt. Gjatë punës në Katedrën e Historisë të Universitetit të Prishtinës, ishte mësimdhënëse e këtyre lëndëve në studimet themelore: *“Histori e Popullit Shqiptar IV”*, *“Histori Bashkëkohore Shqiptare”* dhe *“Histori e Integritimeve Evropiane”*, ndërsa në studime

postdiplomike për master, ligjëroi lëndët: “*Historiografi Shqiptare e Shekullit XIX-XX*” dhe “*Historia e Kosovës 1912-2008*”.

Prof. dr. Emine Arifi-Bakalli gjatë kohë sa ka punuar si mësimdhënëse pranë Katedrës së Historisë në Universitetin e Prishtinës, ka udhëhequr dhe mentoruar disa kandidatë, të cilën me sukses kanë marrë gradën shkencore doktor në shkencën e historisë. Përveç udhëheqjes shkencore në temat e doktoratës, ajo ka udhëhequr edhe një numër të madh të kandidatëve, të cilët me suksese e kanë mbrojtur gradën e magjistraturës dhe më pas atë të masterit të shkencave, si dhe ka udhëhequr një numër të madh të studentëve në punimet e diplomës. Ajo ka recensuar edhe një numër të monografive dhe të punimeve shkencore.

Prof. dr. Emine Arifi-Bakalli ishte një historiane e shquar, e cila ka korrur rezultate në fushën e shkencës, e me zell të veçantë ka zhvilluar ekspertiza shkencore, ku kërkimet e saja shkencore ishin të fokusuara tek historia e shqiptarëve mes dy luftërave botërore, duke trajtuar me kujdes dhe kompetencë profesionale aspektet ekonomike si dhe marrëdhëniet diplomatike mes shqiptarëve dhe jugosllavëve, më pas pozitën politike të shtetit shqiptar në kuadrin ballkanik dhe evropian. Ajo ka trajtuar edhe marrëdhëniet italo-shqiptare, si dhe italo-jugosllave. Një interesim të veçantë profesor Arifi-Bakalli, i ka kushtuar edhe gjendjes së popullit shqiptar në kuadër të Mbretërisë së Jugosllavisë.

Gjatë karrierës së saj prej studiueses, ajo ka botuar këto monografi:

1. *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939*, botuar më 1997 nga Instituti i Historisë në Prishtinë.
2. *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, botuar më 2011 nga Instituti Albanologjik i Prishtinës.
3. *Përballje historiografike*, botuar më 2015 nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, dhe
4. *Drejt eliminimit të faktorit shqiptar në Ballkan: qëndrimi i Jugosllavisë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve 1935-1939*, botuar më 2022 nga Instituti i Historisë në Prishtinë.

Po ashtu, përveç botimeve shkencore dhe shumë punimeve shkencore nëpër revista të ndryshme shkencore, ajo ka marrë pjesë edhe në shumë tryeza, simpoziume e konferenca shkencore vendore e ndërkombëtare. Ajo

është autore edhe e një numri të konsiderueshëm të teksteve të historisë për shkollat fillore dhe ato të mesme në Republikën e Kosovës.

Prof. dr. Emine Arifi-Bakalli, në fillim të viteve '90-të të shekullit XX, u vu në ballë të mbrojtjes së Universitetit të Prishtinës nga masat e dhunshme që po i instalonte regjimi serb i Beogradit. Kështu, për shkak të aktivitetit të saj në dhjetor të vitit 1991, u përjashtua nga puna si mësimdhënëse pranë Katedrës së Historisë. Pas përjashtimit nga puna, ajo dha kontribut të madh në organizimit e mësimit sipas plan-programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës gjatë gjithë periudhës së viteve të '90-ta. Ishe redaktore për shkencat shoqërore pranë Këshillit Botues të Universitetit të Prishtinës.

Pas përfundimit të luftës çlirimtare të viteve 1998-1999, ajo vijoi angazhimet e saj pranë Katedrës së Historisë të Universitetit të Prishtinës. Ishte anëtare e grupit të ekspertëve për planet dhe programet mësimore pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës. Ishte anëtare e redaksisë për historinë e Shqipërisë dhe shqiptarëve në shekullin XX të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, botuar disa vite më parë, po nga kjo Akademi.

Më 3 gusht 2024, prof. dr. Emine Arifi-Bakalli, i mbylli sytë përgjithmonë, lajm ky që u kumtua nga familjarët e saj. Me rastin e vdekjes së profesoreshë Eminës, familjen Arifi-Bakalli e ka ngushëlluar rektori i Universitetit të Prishtinës, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Instituti i Historisë në Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, ministra, deputetë e ish-zyrtarë të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës, kolegë historianë nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut, e shumë studentë e bashkëpunëtorë të ngushtë të saj. Vdekja e profesorësh Emine Arifi-Bakalli, është një humbje e madhe për historiografinë shqiptare, e cila lë një boshllëk të madh për periudhën në të cilën studimet e saja ishin të fokusuara. Profesoreshë Arifi-Bakalli me punën e saj akademike e shkencore ka lënë gjurmë të mëdha dhe kontribut të jashtëzakonshëm shkencor, që do të jenë bazament për historinë dhe historiografinë shqiptare.

Shkodran IMERAJ & Alban DOBRUNA